



SHQIPËRIA NË KONFERENCËN E PALËVE MBI KLIMËN, PARIS 2015



Ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka, mori pjesë në Konferencën e Palëve për Ndryshimet Klimatike që u mbajt

në Paris nga data 30 nëntor - 11 dhjetor 2015.

Ministri Koka ndoqi "Segmentin e Nivelit të Lartë të COP21/CMP11", që u zhvillua në datat 7 dhe 8 dhjetor 2015. Gjatë takimeve dhe tryezave të rumbullakëta ministri Koka shprehu gatishmërinë e qeverisë shqiptare për t'u bashkuar në sfidën globale ndaj ndryshimeve klimatike. "Shqipëria dorëzoi Kontributin Kombëtar të Synuar (INDC) në Shtator 2015, para afatit të përcaktuar, duke marrë angazhimin për ndryshimet klimatike dhe duke u rreshtuar krahas shteteve të tjera. Angazhimet e vendit tonë për redukti-

min e emetimeve të Gazeve me Efekt Serrë janë përfshirë në dokumentin e miratuar të INDC-së, sipas të cilit synohet një reduktim prej 11.5% i tyre deri në vitin 2030."- është shprehur ministri Koka.

Gjatë punimeve të Konferencës, Shqipëria është mbështetur në rritjen e kapaciteteve administrative, hartimin e politikave dhe legjislacionin për ndryshimet klimatike në linjë me politikën e BE-së.

Shqipëria ka përgatitur dhe miratuar dokumentin e INDC-së, si kontributin tonë kombëtar të pikësnyuar në kuadër të përpjekjeve globale për reduktimin e emetimeve të Gazeve me Efekt Serrë dhe mbajtjen e temperaturës nën 2°C. Për zbatimin e INDC-së mbetet për t'u marrë një

paketë masash, e cila synon reduktimin me 11.5% të gazeve me efekt serrë që lidhen me investimet në fushën e ndërtimit, industrisë dhe transportit.

Kostoja totale e këtyre masave deri në vitin 2030 është rreth 687 milion euro. Shumica e masave të identifikuar për përcaktimin e INDC-së janë masa të lidhura me përdorimin me eficientë të burimeve energjetike, aplikimin e energjive të rinovueshme dhe biokarburantet.

Konferenca e Palëve mbi Klimën, Paris 2015, merr një rëndësi tepër të veçantë, duke qenë se për herë të parë në më shumë se 20 vjet negociata të OKB-së u arrit një marrëveshje ligjërisht e detyrueshme dhe universale mbi klimën, me qëllim mbajtjen e ngrohjes globale nën 2°C.

ARRITJET E KONFERENCËS SË PALËVE MBI KLIMËN

Paris, 12 Dhjetor 2015 - Delegatët e 172 vendeve të botës arritën një pakt të ri global mbi klimën. Pas gati dy javësh negociatash intensive, në Paris, Francë, u arrit marrëveshja që do të përcaktojë strategjinë afatgjatë për mënyrat dhe rrugët që do të ndiqen për t'u përballur me sfidat e ndryshimeve klimatike.

Marrëveshja për të kufizuar temperaturën globale në më pak se 2 gradë C u arrit në Samitin e Parisit për Ndryshimet Klimatike, pas një pune intensive negociuese. Pakti, pikë së pari synonte të bindte vendet që të merrnin masa për të ulur shkarkimet e karbonit. Për të mundësuar fleksibilitetin e nevojshëm për vendet anëtare, marrëveshja është pjesërisht detyruese dhe pjesërisht vullentare. Më parë, blloku kryesor përfshinte G77, grupin e vendeve të zhvilluara, dhe shtete si Kina ashtu edhe India, u deklaruan në mbështetje të propozimeve për kufizim të shkarkimeve të karbonit.

Presidenti i Konferencës së Palëve për Klimën (COP) i Kombeve të Bashkuara, njëherazi edhe Ministri i Jashtëm i Francës, z. Laurent Fabius u shpreh: "Ne tani ftojme Konferencën e Palëve të miratojë vendimin e quajtur Marrëveshja e Parisit. Përpjekja jonë kolektive vlen më shumë se totali i përpjekjeve tona individuale. Përgjegjësia jonë ndaj historisë është e madhe. Qëllimi kryesor i kësaj Marrëveshje universale është mbajtja e temperaturës globale nën 2 gradë C gjatë këtij shekulli dhe nxitja e përpjekjeve për të kufizuar rritjen e temperaturës përtëj 1.5 gradë C të niveleve para të ashtuquajturave vite "industriale". Kufiri prej 1.5 gradë C është një mënyrë më e sigurtë për të luftuar kundër ndikimeve të dëmshme të ndryshimeve klimatike. Përveç kësaj, marrëveshja ka për qëllim të forcojë aftësinë e vendeve për t'u përballur me ndikimet e ndryshimeve klimatike.

Për të arritur objektivat ambicioze të kësaj marrëveshjeje do të duhet të funksionojnë edhe mekanizmat e duhura financiare, duke mundësuar kryerjen e veprimeve të duhura nga vendet në zhvillim dhe nga vendet më të ndikuara, në përputhje me objektivat e tyre kombëtare.

Presidenti Francez, z. Francois Hollande, u tha delegatëve të mbledhur në Paris: "Ju bëtë të mundur arritjen e një marrëveshjeje ambicioze, e një marrëveshjeje detyruese dhe të një marrëveshjeje universale. Unë kurrë nuk do të jem në gjendje për të shprehur mirënjohjen time për këtë. Ju mund të ndieheni krenarë përpara fëmijëve dhe brezave të ardhshëm".

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, z. Ban Ki-Moon u shpreh: "Ne kemi hyrë në një epokë të re të bashkëpunimit global në një prej çështjeve më komplekse, me të cilën është përballur ndonjëherë njerëzimi. Për herë të parë, të gjitha shtetet e botës kanë premtuar njëzëri se do të marrin masa për të ulur shkarkimet e karbonit, të forcojnë kapacitetet e përbalimit të pasojave shkatërruese të ndryshimeve klimatike dhe të bashkohen rreth kauzës së përbashkët për të ndërmarrë veprime kolektive ndaj zbutjes së ndikimeve negative të klimës".

Marrëveshja e Parisit mbulon të gjitha fushat e identifikuar si thelbësore për arritur një objektivi, që mund të quhet historik:

Zbutjen – uljen e shkarkimeve në mënyrë aq të shpejtë sa për të arritur objektivat e vëna në lidhje me temperature.

Një sistem transparent të masave që do të ndërmerren në funksion të ndryshimeve klimatike.

Përshtatja – forcimin e aftësisë të vendeve për të përballuar ndikimet nga ndryshimet klimatike;

Humbja dhe dëmet - forcimi i aftësive për rimëkëmbjen e vendeve nga ndikimet e ndryshimeve klimatike.

Mbështetja financiare, për shtetet që mund të zhvillojnë teknologji të "pastër" për një të ardhme të sigurt.

Marrëveshja e re, gjithashtu, përcakton parimin që planet e ardhshme kombëtare do të jenë jo më pak ambicioze se ato ekzistuese, çka do të thotë se këto 188 plane veprimi të klimës do të mundësojnë ndryshime reale dhe bazën për ambicje edhe më të mëdha.

Vendet do të paraqesin planet e përditësuar të klimës - të quajtura kontribute kombëtare të pikësnyuara (INDC) - çdo pesë vjet, duke rritur në mënyrë të qëndrueshme ambicien e tyre afatgjatë.

NËNSHKRIMI I MARRËVESHJES SË PARISIT

Pas miratimit të Marrëveshjes së Parisit nga ana e COP (Konferenca e Palëve), do të depozitohet në selinë qendrore të organizatës së Kombeve të Bashkuara në Nju Jork dhe do të qëndrojë e hapur për nënshkrim për një vit, deri më datë 22 Prill 2016 - Ditën e Tokës (si planet).

Marrëveshja do të hyjë në fuqi pas depozitimit të instrumenteve të ratifikimit nga ana e 55 vendeve që përbëjnë të paktën 55% të shkarkimeve globale.

Më shumë detaje mbi Marrëveshjen e Parisit.

Të gjitha vendet do të dorëzojnë dokumentet e Komunikimit të Masave të Përshtatjes, ku do të përshkruajnë me hollësi prioritetet e tyre të përshtatjes, nevojat dhe planet për mbështetje.

Vijon në faqen 4

NË KËTË NUMËR:

SHQIPËRIA NË KONFERENCËN E PALËVE MBI KLIMËN PARIS 2015—FQ 1

PREZANTOHET POLITIKA FINANCIARE QË DO NDIJEK MINISTRIA E MJEDISIT GJATË VITIT 2016 - FQ2

LEJET MJEDISORE DHJETOR 2015—FQ 3

NGA AKTIVITETET E ORGANIZATAVE MJEDISORE — FQ4

"Misioni i Ministrisë së Mjedisit, është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit dhe pyjeve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të cilësisë së jetës dhe të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian. Përmes kësaj misioni do të realizohet duke marrë pjesë, nxitje dhe bashkëpunim veprimtarie, të cilat do të zhvillojnë e mirëqenien afatgjatë, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilituar opinionin publik".

PREZANTOHET POLITIKA FINANCIARE QË DO NDJEKË MINISTERIA E MJEDISIT GJATË VITIT 2016



Ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka, prezantoi në Komisionin Parlamentar për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, projektbuxhetin e Ministrisë së Mjedisit për vitin 2016.

Në fjalën e tij, ministri Koka theksoi se: "Buxheti i Ministrisë së Mjedisit për vitin 2016, në tërësinë e tij, shënon një rritje të konsiderueshme prej 49,37%, duke u rritur nga 2,379,121,000 lekë në vitin 2015 në 3,553,800 në vitin 2016."

Ministri i Mjedisit veçoi programin "Mbrojtja e Mjedisit" i cili ka një fokus të veçantë në zërin e investimeve të brendshme dhe ku shënohet një rritje me rreth 3,7 herë të vlerës së parashikuar për investime krahasuar me vitin 2015. Në këtë program përfshihen disa projekte si: vazhdimi i projektit për Ndërtimin e Implantit të Prodhimit të Energjisë nga mbetjet të mbylljen e Venddepozitimit ekzistues të mbetjeve në Elbasan, ndërtimi i Implantit për Prodhimin e Energjisë nga Mbjetet në Qarkun e Fierit, menaxhimi i integruar i mbetjeve spitalore, pastrimi i Lumit Shkumbin, si dhe investime në Zona të Mbrojtura. Në kuadër të strategjisë së prezantuar tashmë nga Ministria

e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura për "Turizëm 360 Ditë".

Një pjesë e buxhetit për vitin e ardhshëm, do të shkojë për Programin Administrimi i Pyjeve, nëpërmjet të cilit do të asistohen bashkitë në programet e tyre të pyllëzimit. Ministria e Mjedisit ka parashikuar që gjatë vitit 2016, nëpërmjet Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, të transferojë pranë Bashkive një fond prej 100,000,000 lekë të rinj të dedikuara vetëm për pyllëzime të reja.

Gjithashtu, një pjesë e buxhetit do të shkojë për të asistuar Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit dhe të Pyjeve në evidentimin e çdo kundrvajtje në fond pyjor, ndërsa gjatë vitit 2016 do të financohet zbatimi i një projekti kombëtar për monitorimin me kamera të akteve kryesore të transportit të lëndës drusore.

Në përfundim të prezantimit të projektbuxhetit 2016, ministri Koka kërkoi rritje të buxhetit nëpërmjet zërit të shpenzimeve operative për 3 institucionet e varësisë AKM, AKZM dhe ISHMP, që për vitin 2016 rezultuan me ulje krahasimisht me një vit më parë në masën -4.76%.

Një seri projektsh të Ministrisë së Mjedisit, si: pajisja e Inspektorëve Pyjorë të Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve dhe Rojeve Mjedisore të AKZM-së me uniformë, kontrolli i planifikuar brenda vitit 2016 në mbi

10,000 subjekte me ndikim në mjedis, monitorimi i cilësisë së ajrit, si edhe i ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore, monitorimi i florës dhe faunës apo edhe monitorimi i Monumenteve të Natyrës etj., nuk do të mund të realizohen me sukses nëse nuk do të mundësohet një shtesë prej të paktën 50,000,000 lekë në programin "Mbrojtja e Mjedisit", dhe një shtesë po prej 50,000,000 lekë në programin "Administrimi i Pyjeve".

Duke vlerësuar vëmendjen e qeverisë shqiptare ndaj Mjedisit, ministri Koka veçoi edhe vlerësimet pozitive të Progres Raportit 2015 në sektorin e mjedisit.

"Ne kemi dy institucione si Agjencia Kombëtare e Mjedisit, e cila ka marrë vlerësim maksimal në Progres Raportin e BE-së. Është rasti i parë kur ne kemi mundur të raportojmë periodikisht në kohë reale për Agjencinë Evropiane të Mjedisit në lidhje me monitorimin e cilësisë së ajrit, cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Edhe Inspektoriat Shtetëror i Mjedisit dhe i Pyjeve, një institucion i ri ky, ka marrë vlerësimet maksimale në Progres Raportin e 2015-ës.

Janë institucione që, siç dhe në fakt është dhënë sugjerim në Progres Raport, duhet të mbështeten me logjistikë dhe shpenzime të tjera operative, pasi e kanë të domosdoshme një mbështetje të tillë për ushtrimin e detyrës së tyre - u shpreh Ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka.

VENDIMET E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS, DHJETOR 2015

Nr.	SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDODHJA	VENDIMI
1	QENDRA KOMBËTARE PRITËSE PËR AZILKËRKUES	VP NDËRTIMI I GODINËS SË AKOMODIMIT NË QENDËR BABRRU	RRUGA M. KETA, ISH REPARTI USHTARAK XIHENJO, TIRANË	VENDIM PËR VNM PARAPRAKE
2	ROZAFI 96	VP BANESA INDIVIDUALE	SHKODËR	VENDIM PËR VNM PARAPRAKE
3	ZENELI - ZENTOL	TRANSFERIM VENDIMI PARAPRAK IMPLANT KROMI	BULQIZË, DIBËR	VENDIM PËR VNM PARAPRAKE
4	VODAFONE AL	VP SHESH NDËRTIMI	RROGOZHINË, TIRANË	PLOTËSIM INFORMACIONI

Nr.	SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDODHJA	VENDIMI
1	DEVOLL HYDROPOWER	VP NDËRTIM SHKOLLË	GRAMSH, ELBASAN	VENDIM PËR VNM PARAPRAKE
2	DPUK VLORË	VP KANALIZIME	VLORË	VENDIM PËR VNM PARAPRAKE
3	DEVOLL HYDROPOWER	VTH SHFRYTËZIM 712/ 5	MOGLICË, KORÇË	DEKLARATË MJEDISORE
4	DEVOLL HYDROPOWER	VTH SHFRYTËZIM 712/6	MOGLICË, KORÇË	DEKLARATË MJEDISORE
5	AGRI PRODUCTS EUROPE	VP NDËRTIM KOMPLEKSI PËR KULTIVIM KËRPUDHASH	SEMAN-TOPOJË, FIER	REFUZIM
6	KASTRA KONSTRUKSION	VP KOMPLEKS HOTELIERIE VILA 2 KATË DHE HOTEL 3 KAT	VELIPOJË, SHKODËR	REFUZIM
7	KOKA sh.p.k.	VTH SHFRYTËZIM I MINERALIT TË KROMIT	KAPTINË, KRASË, DIBËR	DEKLARATË MJEDISORE
8	AGRO AL	VP NDËRTIM SHITESË OBJEKTI	DURRËS	VENDIM PËR VNM PARAPRAKE
9	G.P.G COMPANY	VP NDËRTIM 6 GODINA SHËRBIMI HOTELIERI	DHËRMI VLORË	PLOTËSIM INFORMACIONI
10	ALLBENIA FERRO	VTH SHFRYTËZIM KUARC	KËRRNAJË, TROPOJË	DEKLARATË MJEDISORE

LEJET MJEDISORE DHJETOR 2015

SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDNDODHJA	VENDIMI	TIPI I LEJES
K.I.D -Alb (Lc-3734)	Prodhim i produkteve qeramike nëpërmjet pjekjes, përfshirë tjegullat dhe tullat	Maminas, Durrës	Refuzim	Tipi B
Doruz	Nxjerrja e mineraleve të rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret	Skrapat, Berat	Miratim	Tipi B
Min-Ex	Miniera nëntokësore dhe veprimtari të lidhura me to. Nxjerrja e mineraleve të rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret	Elbasan	Miratim	Tipi B
Krasta	Nxjerrja e mineraleve të rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret	Martanesh, Dibër	Miratim	Tipi B
Xhireton	Miniera nëntokësore dhe veprimtari të lidhura	Martanesh, Dibër	Miratim	Tipi B
Agimi	Prodhim i produkteve të tjera jometalike	Gjirokastrë	Miratim	Tipi B
Ernisi	Nxjerrja e mineraleve të rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur	Myc-Has, Kukës	Refuzim	Tipi B
Vëllezërit Hysa L.C. 3775	Përzjerje të çimentos, grumbullim betoni, prodhim blloqe betoni	Gostime, Elbasan	Refuzim	Tipi B
Albmerkuri	Minierë nëntokësore dhe sipërfaqësore.	Martanesh, Dibër	Miratim	Tipi B
Alxhef	Prodhim i produkteve prej druri, sharrim, gdhendje, tornimim druri	Fushë-Prezë, Tiranë	Miratim	Tipi B

SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDNDODHJA	VENDIMI	TIPI I LEJES
Rosi Construction	Nxjerrja e mineraleve të rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur	Hotolisht, Elbasan	Miratim	Tipi B
Titan Construction 2000	Nxjerrja e mineraleve të rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur	Finiq, Vlorë	Refuzim	Tipi B
Eroget	Rritje intensive e shpendëve në një instalim	Radosinë, Fier	Miratim	Tipi B
Elba Beton	Përzjerje të çimentos, grumbullim betoni, prodhim blloqe betoni	Bradashesh, Elbasan	Refuzim	Tipi B
Euro Mega 2010	Prodhim i kimikateve organike bazë	Afmetaq, Tiranë	Miratim	Tipi B
Bankers Petroleum Albania LTD (L.C – 3438)	Nxjerrja e naftës dhe gazit natyror	Patos - Marinzë, Kuman, Fier	Refuzim	Tipi A
Bankers Petroleum Albania LTD (L.C – 3445)	Nxjerrja e naftës dhe gazit natyror	Patos - Marinzë, Kallm i Madh, Fier	Refuzim	Tipi A
Bankers Petroleum Albania LTD (L.C – 3448)	Nxjerrja e naftës dhe gazit natyror	Patos- Marinzë, Kuman, Fier	Refuzim	Tipi A
Bankers Petroleum Albania LTD (L.C – 3441)	Nxjerrja e naftës dhe gazit natyror	Patoz-Marinzë, Fier	Refuzim	Tipi A
Bankers Petroleum Albania LTD (L.C – 3444)	Nxjerrja e naftës dhe gazit natyror	Fshati Zharrëz	Refuzim	Tipi A
LIMAK INSAAT SANAYI ve TICARET	III.2.B Transportim i gomave të përdorura	Komuna Klos, Elbasan	Refuzim	Tipi B
Bankers Petroleum Albania LTD (L.C – 3447)	Nxjerrja e naftës dhe gazit natyror	Bashkia Rroskovec, Qarku Fier	Refuzim	Tipi A

E ARDHMJA E MINISTRISË SË MJEDISIT



Ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka, priti sot të punësuarit më të rinj në administratën e Ministrisë së Mjedisit dhe institucioneve të varësisë. Ata janë përzgjedhur mes profesionistëve të rinj që kryen praktikën e punës në Ministrinë e Mjedisit dhe institucionet e varësisë. Në fjalën e tij, ministri Koka uroi nëpunësit më të rinj të administratës për arritjen e rezultatit maksimal gjatë kryerjes së praktikës, duke shprehur besimin se brezi i profesionistëve të rinj do të sjellë impakt pozitiv në administratën publike.

“Komunikimi i hapur për t’u shërbyer qytetarëve dhe përkushtimi është filozofia që duhet ndjekur nga ju. Ndërthurja e brezave në administratë mendoj se është shumë pozitive dhe ju duhet të shfrytëzoni mundësinë e dhënë për t’u rritur profesionalisht. Duhet të sillni atë


frymë të re të inovacionit, kërkesës, komunikimit, të cilët unë besoj se ju e keni për deri sa keni arritur deri këtu. Më vjen mirë që në fund ju i keni shpërblyer mundin dhe djersën e familjeve tuaja, prindërve të cilët kanë sakrifikuar për shkollimin tuaj dhe për t’u bërë këta që jeni sot. Kontributi juaj do të jetë i vyer për sektorët ku ju do të angazhoheni”, - tha ministri Koka, duke u uruar të rinjve punë të mbarë.

Praktikantët falenderuan Ministrin e Mjedisit për mundësinë e dhënë dhe mbështetjen që kanë gjetur nga stafi i Ministrisë së Mjedisit dhe institucioneve të saj të varësisë.

Gjashtë fituesit e praktikës së punës, janë më të mirët e përzgjedhur nga 37 profesionistë të rinj të moshës nga 21 deri në 26 vjeç, që kryen praktikën e punës në administratën e Ministrisë së Mjedisit dhe institucioneve të saj të varësisë, në kuadër të “Programit Kombëtar të Prak-

tikave të Punës në Administratën Shtetërore” dhe institucionet e tjera publike. Ata janë përzgjedhur në bazë të arritjeve të tyre në shkollim, aftësive të treguara gjatë praktikës së punës dhe nevojave për punësim që kishte administrata e Ministrisë së Mjedisit dhe institucionet e saj të varësisë, duke fituar një kontratë 1 vjeçare punësimi.

Në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës 37 praktikantët kryen praktikën e punës pranë Ministrisë së Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Drejtorisë Rajonale të Mjedisit, Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura për një periudhë kohore 3 muaj, korrik– shtator 2015. Qëllimi i kësaj praktike ishte përfitimimi i një përvojë kualifikuese, që ndikon në zhvillimin e aftësive profesionale, si edhe të shprehive praktike dhe njohjen me sistemin administrativ publik. Praktika 3 mujore do të njihet si përvojë pune.



... ARRITJET E KONFERENCËS SË PALËVE MBI KLIMËN

(vijon nga fq 1)

Vendet në zhvillim do të përfitojnë mbështetje për veprimet apo masat adaptive, e cila do të vijë duke u rritur, në varësi të nivelit të masave që do të merren.

- Mekanizmi ekzistues i Varshavës për humbjen dhe dëmtimin do të forcohet në mënyrë të konsiderueshme.
- Marrëveshja përfshin një kornizë të fuqishme transparence, si për veprimet që do të ndërmerren, ashtu dhe për mbështetjen që do të jepet. Kuadri do të qartësojë veprimet e vendeve lidhur me zbutjen dhe përshtatjen, si edhe ofrimin e mbështetjes. Në të njëjtën kohë, ajo njeh faktin se vendet më pak të zhvilluara apo edhe shtetet ishullore, me sipërfaqe të vogla, përbëjnë raste të veçanta.
- Marrëveshja përfshin një inventarizim global që fillon në vitin 2023 për të vlerësuar progresin e përbashkët drejt qëllimeve të marrëveshjes. Inventarizimi do të bëhet çdo

pesë vjet.

- Marrëveshja përfshin një mekanizëm pajtueshmërie, i mbikëqyrur nga një komision ekspertësh që vepron në mënyrë jo-ndëshkuese ndaj vendeve. Gjithashtu, COP-i i dha zgjidhje edhe një numri çështjesh teknike.
- Në kuadër të Protokollit të Kiotos, tani ka një metodë të qartë dhe transparente për metodën e llogaritjes së krediteve të karbonit për periudhën e dytë të angazhimit, duke krijuar një përmbljedhje të qartë të rregullave.
- Raundi i parë i procesit ndërkombëtar të vlerësimit dhe rishikimit (IAR), që u prezantua në vitin 2014 ka përfunduar me sukses.
- Gjithashtu, një numër çështjesh dhe zbatimi teknik lidhur me marrëveshjet ekzistuese mbi teknologjinë, përshtatjen, veprimin për forcimin e klimës dhe ngritjen e kapaciteteve, kanë përfunduar me sukses.

PIKAT KRYESORE

Masat në marrëveshje përfshijnë:

- Arritjen e kulmit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë sa më shpejt të jetë e mundur dhe arritjen e një balance mes burimeve dhe shkarkimeve të gazeve me efekt serrë në gjysmën e dytë të këtij shekulli.
- Mbahta nën kontroll e temperaturës, poshtë 2 gradë C (3.6F), dhe vazhdimin e përpjekjeve për ta kufizuar atë në 1.5 gradë C.
- Shqyrtimin e progresit të vendeve çdo pesë vjet.
- Financimi i vendeve në zhvillim për ndryshimet klimatike do jetë 100 miliard \$ në vit, deri në vitin 2020, dhe angazhim për financime të mëtejshme në të ardhmen.



NGA AKTIVITETET E ORGANIZATAVE MJEDISORE



MBJELLJE PEMËSH NGA SHOQATA "ALPIN"

"Të përmirësojmë mjedisin ku ne jetojmë", ka qenë një ndër aktivitetet ndërgjegjësuese që ka ndërmarrë shoqata mjedisore Alpin, në Tropojë.

Nje ide e hedhur nga grupi ekologjik i të rinjve në shkollën 9-veçare Margegaj u konkretizua në një nismë, e cila tërhoqi shumë aktorë, si: drejtorinë dhe bordin e shkollës, këshillin e mësuesve, këshillin e prindërve, pushtetin vendor dhe organizmat tje tërë. Pjesë e nismës "E ardhmja fillon tek ne" u konkretizua gjatë gjithë muajit dhjetor nga nxënësit e kësaj shkolle. Ndaj, vazhdimisht gjatë këtyre viteve shoqata Alpin ka mbështetur nisma me natyrë mjedisore, duke mos ngelur as këtë vit vetëm në rrafshin e ndërgjegjësimit, por duke vijuar me aksionin për mbjelljen e pemëve dekorative në oborrin e kësaj shkolle.

Zoti Astrit Metalija u shpreh: "Nëpërmjet këtij aktiviteti duam të ndërgjegjësojmë opinionin e gjërë se çdokush mundet të kujdeset për mjedisin dhe të japë kontributin e tij të thjeshtë dhe modest dhe jo të dëmtojë mjedisin në çdo kohë për përfitime personale, gjë që sjell prishje të ekuilibrave natyrore".

AOS – TË PROMOVOJMË FAUNËN SHQIPTARE

Mjaft aktive ka qenë gjatë muajit dhjetor edhe shoqata AOS - Shoqata Shqiptare e Shpendëve (Albanian Ornitho-



logical Society), shoqatë e kryesuar nga z. Taulant Bino.

Ditët e fundit të dhjetorit kjo shoqatë organizoi një tur me gazetarë në Parkun Kombëtar Divjakë—Karavasta, për promovimin e pasurisë natyrore që kjo zonë ofron dhe në veçanti për numrin e shpendëve që popullojnë këtë Park Natyror. Pas trajnimeve të para që kjo shoqatë ka ofruar për të përgatitur ekspertë që do të drejtojnë ture për vëzhgimin e shpendëve dhe jetës së egër në Shqipëri, (birdwatching dhe wildlife), përfshirja e gazetarëve që një nismë tjetër për të mundësuar promovimin e faunës shqiptare.

Zgjedhja e Karavastës për t'u vizituar nga gazetarët nuk që e rastësishme, shprehet në rrjetet sociale z. Bino. Karavastaja është zona më e rëndësishme për shpendët në Shqipëri, me numrin më të lartë të shpendëve, të shpërndarë në një mozaik habitatesh, përfshirë ligatina, lumenj, ujëra bregdetare, pyje me pisha. "Ajo strehon gjatë gjithë vitit mbi 245 lloje shpendësh, nga 330 të vrojtuarat në të gjithë Shqipërinë".

TRAJNIMI MBI PAKËSIMIN E RREZIKUT NGA KATASTROFAT

Qendrat e Aarhusit në Shqipëri morën pjesë në trajnimin "Pakësimi i Rrezikut nga Katastrofat dhe Siguria", që u



zhvillua në Mal të Zi, në datat 7, 8, 9 dhe 10 dhjetor 2015.

Ky trajnim u organizua nga Zyra e Koordinatorit për Aktivitetet në fushat e Ekonomisë dhe Mjedisit, me bazë në selinë qendrore të OSBE-së në Vienë, në bashkëpunim me prezencën e OSBE-së në Shqipëri dhe Misionin e OSBE-së në Mal të Zi.

Nga pala shqiptare merrnin pjesë ekspertë e emergjencave civile, urbanistët apo edhe këshilltarët bashkiakë të bashkive Shkodër, Vlorë dhe Lezhë, si edhe menaxherët e Qendrave të Informacionit Aarhus Tiranë, Shkodër dhe Vlorë. Në këtë trajnim merrnin pjesë edhe përfaqësues nga autoritete lokale të qendrave të Aarhusit dhe përfaqësuesve të Agjencisë së Emergjencave të Malit të Zi.

Trajnimi synonte rritjen e kapaciteteve të ekspertëve të emergjencave civile, urbanistëve dhe të Qendrave Aarhus në Shqipëri dhe Mal të Zi mbi parimet e parandalimit, përgatitjes dhe përgjigjes ndaj rreziqeve të katastrofave. Gjatë ditëve nuk u zhvilluan vetëm mekanizmat që duhen për të rritur mundësinë e shmangies së katastrofave apo pakësimit të dëmit në raste të tilla, por u pa dhe në praktikë se si ishin menaxhuar situatat e përmytjeve në qytetin e Cetinjës. Një nga arritjet e këtij trajnimi ishte edhe vendosja e bashkëpunimit për raste të përbashkëta të katastrofave natyrore mes ekspertëve të Shqipërisë dhe Malit të Zi.